



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



MË 7 GUSHT MBAHET PROTESTË GJITHËPOPULLORE KUNDËR SPECIALES

FAQE 4-5



Organizatrat e dala nga lufta e UÇK-së kanë njoftuar se më 7 gusht do ta mbajnë një protestë gjithë popullore kundër Gjykatës Speciale dhe në mbështetje të liderëve të UÇK-së e bashkëluftëtarëve të tyre të cilat janë

duke u gjykuar në Hagë. Ata kanë vlerësuar se kjo protestë është e domosdoshme për të kërkuar drejtësi dhe për ta mbrojtur luftën e drejtë të UÇK-së. Sipas tyre, Specialja është duke i shkelur të

drejtat e luftëtarëve të lirisë të cilët janë duke u mbajtur në paraburgim. Po ashtu, ata kanë kritikuar institucionet e Kosovës për mospërkrahjen e duhur financiare për liderët e UÇK-së

PROTESTË KUNDËR PADREJTËSISË!

7 GUSHT ORA 17:00

Sheshi "Skënderbeu", Prishtinë

ORGANIZOHET NGA KATEGORITË E DALA NGA LUFTA E UÇK-SË

KOSOVA NË 'GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME TË PASHPALLUR'



Njohës të çështjeve politike dhe monitorues të punës së Kuvendit kanë vlerësuar se shteti i Kosovës është në gjendje të jashtëzakonshme të pashpallur. Sipas tyre, kjo gjendje është pasojë e dështimit të deputetëve për ta përmbyllur konstituimin e Kuvendit deri më 26 korrik, ashtu siç kishte kërkuar

Gjykata Kushtetuese. Ndërsa Ambasada e ShBA-së ka vlerësuar se ngërçi politik është duke rrezikuar integritetin e institucioneve të Kosovës. Në këtë kontekst, kjo ambasadë u ka bërë thirrje liderëve politikë të punojnë për të arritur një marrëveshje për konstituimin e Kuvendit

RENOVA

PUTZ

Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini


FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

AKTUALE



**FSK-ja ME LEJEN E KFOR-it
PËRFSHIHET NË OPERACIONIN
E KËRKIMIT NË UJMAN** F. 5

**KRASNIQI: KOMUNAT QË
UDHËHIQEN NGA PDK-JA,
KAMPIONE TË TRANSPARENCËS** F. 6

**HOTI: KUSHTETUESJA DUHET
T'I ZGJIDHË PROBLEMET POLITIKE
QË I KA KRIJUAR VETË** F. 5

EKONOMI



**MURATI: NGA KY MUAJ
SHËRBYESVE PUBLIKË U SHTOHEN
EDHE 55 EURO NË PAGA** F. 8

**GËRXXHALIU: PARAMETRAT
EKONOMIKË NË KOSOVË JANË
SHQETËSUES** F. 8

SPORT



**RADONIQI FTON MËRGATËN TË
REGJISTROHET PËR VOTIM ME POSTË** F. 10

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Shqipëria arreston 18 persona të dyshuar për zjarrvënie

TIRANË, 29 KORRIK - Autoritetet në Shqipëri kanë arrestuar 18 persona, të dyshuar për zjarrvënie në pjesë të ndryshme të vendit. Prej mesit të qershorit, mbi 12 000 hektarë, përfshirë pyje dhe ullishte, janë dëmtuar si pasojë e zjarreve që janë përhapur në këtë vend të Ballkanit, sipas grupeve për mbrojtje të ambientit. Disa dhjetëra zjarre kanë shpërthyer në ditët e fundit, disa prej tyre jo shumë larg bregdetit plot me turistë. “Zjarrvënia nuk është thjesht krim - është kërcënim për

jetën, natyrën dhe të ardhmen”, ka thënë Ministria e Brendshme e Shqipërisë në një deklaratë të martën. Ata që shpallen fajtorë për nisje të qëllimshme të zjarreve mund të dënohen me pesë vjet burgim, “mirëpo nëse zjarri shkakton dëm të konsiderueshëm material dhe ka pasoja serioze në jetën dhe shëndetin e njeriut, Kodi Penal parasheh dënime prej 10 deri në 15 vjet”, ka thënë ministria. Për disa zjarre aktive është raportuar edhe të martën në Shqipëri teksa vendi është në pritje të ulje të temperaturave,

Gjithë rajoni i Ballkanit ka regjistruar temperatura në deri 40 gradë celsius në ditët e fundit. Edhe në Kosovë është raportuar për disa zjarre aktive. Sipas të dhënave të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent më 28 korrik, ekipet e agjencisë i kanë raportuar 29 vatra zjarri dhe prej tyre 23 janë lokalizuar, ndërsa gjashtë kanë mbetur aktive. Sipas Sistemit Evropian të Informacionit për Zjarret në Pyje (EFFIS), gjatë vitit 2024 në Kosovë janë regjistruar 94 zjarre, të cilat kanë djegur gjithsej 12 079 hektarë pyje dhe shkurre.



Ekspertët e krizave ushqimore: Skenari më i keq i urisë po ndodh në Gaza

GJENEVË, 29 KORRIK - “Skenari më i keq i urisë po ndodh aktualisht në Rripin e Gazës”, ka thënë autoriteti kryesor ndërkombëtar për kriza ushqimore më 29 korrik, duke parashikuar “vdekje të shumta” nëse nuk merren masa të menjëhershme. Ky paralajmërim, që ende nuk përbën shpallje zyrtare të urisë, vjen pas reagimeve të shumta pas publikimit të imazheve të fëmijëve të kequshqyer dhe raportimeve për dhjetëra vdekje të lidhura me urinë pas gati 22 muajsh luftë. Presioni ndërkombëtar e shtyu Izraelin që gjatë fundjavës të shpallë disa masa, përfshirë ndalesa të përditshme në luftime për shkaqe humanitare në disa pjesë të Gazës dhe hedhjen nga ajri të pakove me ndihma. Megjithatë, Kombet e Bashkuara dhe palestinezët në Gaza kanë thënë se situata ka ndryshuar pak, teksa turmat e dëshpëruara të palestinezëve vazhdojnë të dynden drejt kamionëve me ndihma para se ato të arrijnë në destinacionet e parapara. Klasifikimi i Integruar i Sigurisë Ushqimore (IPC) paralajmëroi se Gaza që dy vjet është buzë urisë, por



zhvillimet e fundit kanë “përkallëzuar në mënyrë dramatike” situatën. Shpallja zyrtare e urisë, që

është e rrallë, kërkon të dhëna që nuk mund të merren në Gaza për shkak të pengimit të qasjes në këtë territor. Por,

ekspertët e pavarur kanë thënë se nuk kanë nevojë për një shpallje formale për të kuptuar atë që po shohin në Gaza.

“Ashtu si një mjek familjar mund ta diagnostikojë shpesh një pacient me të cilin është i njohur bazuar në simptomat e dukshme, pa pasur nevojë të dërgojë mostra në laborator dhe të presë rezultatet, po ashtu mund t'i interpretojmë simptomat e Gazës. Kjo është uri e vërtetë”, ka thënë për “Associated Press Alex de Waal, autor i librit “Uria Masive: Historia dhe e ardhmja e saj” dhe drejtor ekzekutiv i Fondacionit për Paqe Botërore. Teksa situata humanitare në Gazë është rënduar, Ministria e Shëndetësisë në territorin palestinez ka njoftuar të martën se numri i viktimave që nga nisja e luftës më 2023 ka shkuar në mbi 60 mijë. Lufta në Gaza ka nisur më 7 tetor 2023, kur radikalët e Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, kanë sulmuar jugun e Izraelit, duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Afër 50 persona besohet se ende mbahen në Gazë, ndërsa të tjerët janë liruar në marrëveshjet paraprake të armëpushimit.

Holanda ua ndalon hyrjen dy ministrave izraelitë për shkak të Gazës

AMSTERDAM, 29 KORRIK - Ministria e Jashtme e Holandës ka njoftuar se do t'ua ndalojë hyrjen në shtet dy ministrave izraelitë të ekstremit të djathtë për shkak të situatës së përkeqësuar humanitare në Gazë. Kjo ndalesë dhe masa të tjera janë bërë publike përmes një letre që ministri i Jashtëm, Caspar Veldkamp, ua ka dërguar

ligjvënësve, duke thënë se “lufta në Gazë duhet të ndalet”. Ndalesa shënjestron ministrin e Sigurisë Kombëtare të Izraelit, Itamar Ben-Gvir, dhe atë të Financave, Bezalel Smotrich, që janë dy partnerë kyç të koalicionit të kryeministrit Benjamin Netanyahu. Të dy janë përkrahës të fuqishëm të lëvizjes së vendbanimeve izraelite dhe

mbështesin vazhdimin e luftës në Gaza, duke lehtësuar atë që ata e quajnë emigrim vullnetar të popullsisë palestineze dhe ndërtimin e vendbanimeve hebreje atje. Britania, Australia, Kanadaja, Zelanda e Re dhe Norvegjia kanë vendosur sanksione financiare ndaj këtyre dy ministrave muajin e kaluar.



MË 7 GUSHT MBAHET PROTESTË GJITHËPOPULLORE KUNDËR SPECIALES

Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së kanë njoftuar se më 7 gusht do ta mbajnë një protestë gjithëpopullore kundër Gjykatës Speciale dhe në mbështetje të liderëve të UÇK-së e bashkëlufëtarëve të tyre të cilat janë duke u gjykuar në Hagë. Ata kanë vlerësuar se kjo protestë është e domosdoshme për të kërkuar drejtësi dhe për ta mbrojtur luftën e drejtë të UÇK-së. Sipas tyre, Specialja është duke i shkelur të drejtat e luftëtarëve të lirisë të cilët janë duke u mbajtur në paraburgim. Po ashtu, ata i kanë kritikuar institucionet e Kosovës për mospërkrahjen e duhur financiare për liderët e UÇK-së



Qeverinë në detyrë të Kosovës lidhur me pagesat për mbrojtjen e ish-krerëve të UÇK-së që gjenden në paraburgim në Hagë.

Kreu i OVLUÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se i është drejtuar ministres në detyrë të Drejtësisë, Albulena Haxhiu, për këtë çështje, por nuk ka pranuar përgjigje. Ai ka thënë se para dy vjetësh e gjysmë Qeveria e Kosovës ka bërë ndryshime sa i përket mbështetjes financiare për të akuzuarit nga Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë, duke vendosur çmim tavan për mbrojtjen.

Gucati, që e ka cilësuar vendimin të padrejtë dhe gabim të madh, tha se për shkak të pagesave, veçse janë larguar disa avokatë, duke përmendur mbrojtësin e Kadri Veselit dhe dy avokatë të Hashim Thaçit. “Ajo (Qeveria e Kosovës) ka marrë një çmim tavan për të paguar mbrojtjen dhe nuk jep para shtesë, siç ka qenë para katër vjetësh. Para katër vjetësh ka qenë çmimi jo i limituar, sa e ka pasur orën mbrojtja, aq e ka paguar qeveria”, ka thënë Gucati, duke akuzuar qeverinë se nuk “po e kthen kokën” nga njerëzit që gjenden në Hagë.

Ditë më parë është raportuar se për shkak të çështjes së pagesave mund të largohen avokatë që po mbrojnë të akuzuarit nga Dhomat e

njoftuar MD-ja. MD-ja kishte reaguar për çështjen e pagesave të avokatëve kur Ben Emmerson, që mbronte Kadri Veselin, ishte larguar nga ekipi mbrojtës i ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës më 2024. MD-ja atëbotë ka thënë se personat që tërhoqën nga detyra e tyre “mund të gjejnë justifikime të ndryshme, por paga e ulët nuk është një prej tyre”.

Aktualisht në Gjykatën Speciale po zhvillohen disa raste, përfshirë edhe gjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së, përkatësisht ndaj ish-presidentit Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi dhe ish-

Lirim GECI

EPOKA
ERE

PRISHTINË, 29 KORRIK - Organizatat e dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) kanë paralajmëruar mbajtjen e një proteste gjithëpopullore në Prishtinë kundër Gjykatës Speciale më 7 gusht, duke filluar nga ora 17:00. Lajmi është dhënë nga drejtuesit e kësaj organizate të cilët kanë kritikuar ashpër punën e Gjykatës Speciale në Hagë.

Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati, ka thënë se këtë protestë do të organizojnë për shokët e tyre të cilët gjenden në paraburgim në Hagë, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi etj. “Do të protestojmë kundër Dhomave të Specializuara që po shkelin të gjitha të drejtat. Janë dy raste që gjykata po përdor njerëz për të ndikuar në proces duke përgjuar shokët tanë”, ka thënë Gucati.

Ndërsa Xhavit Jashari nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve ka thënë se aktakuza ndaj luftëtarëve të UÇK-së është e padrejtë dhe e ndërtuar nga një gjykatë që, sipas tij, nuk do të duhej të ekzistonte. Ai ka thënë se protesta është e domosdoshme për të kërkuar drejtësi dhe për ta mbrojtur luftën e drejtë të UÇK-së. “Duke e shikuar dhe duke parë edhe ligjin, të gjitha ata që kanë marrë armën dhe i janë përgjigjur luftës, janë brenda një aktakuze të padrejtë nga gjykata. Protesta do të thirret që t’i shprehim kundërshtimet tona, duke kërkuar drejtësi. Lufta e drejtë po atakohet në të gjitha

mënyrat. Na detyron të kërkojmë edhe nga institucionet, sikur të kishim institucione kredibile që çmojnë luftën e drejtë dhe të pastër, që kjo gjykatë është dashur të jetë inekzistente. Ata po mbahen padrejtësisht. Shpresojmë që do ta thotë fjalën përfundimtare. Krerët do të kthehen faqebardhë dhe ta kryejnë punën që e kanë lënë, sepse Kosova ka nevojë për ta. Lufta e UÇK-së e ka sjellë lirinë dhe pas ardhjes së lirisë janë krijuar këto institucione dhe çdo institucion mendoj e ka obligim moral dhe njerëzor t’i mbrojë vlerat dhe sakrificat e popullit”, shtoi Jashari.

Gucati dhe Jashari e kanë cilësuar Gjykatën Speciale të njëanshme, e cila, sipas tyre, ka për qëllim deformimin e luftës çlirimtare të UÇK-së.

OVLUÇK-ja kritikon qeverinë për pagesat e mbrojtjes për të akuzuarit në Hagë

Organizata e Veteranëve e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka kritikuar



**7 GUSHT
ORA 17:00**

Sheshi “Skënderbeu”, Prishtinë

ORGANIZOHET NGA KATEGORITË E DALA NGA LUFTA E UÇK-SË

Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë. Por, Ministria e Drejtësisë më herët ka dalë me një reagim duke thënë se që nga nisja e procesit gjyqësor në Gjykatën Speciale në Hagë janë realizuar pagesa të rregullta në përputhje me marrëveshjet dhe obligimet e përcaktuara paraprakisht.

“Nga fillimi i procesit në total janë paguar 32.944.287.77 euro. Nga kjo shumë, për mbrojtjen e z. Hashim Thaçi janë shpenzuar total: 5.353.301.02 euro”, ka

deputetit të Kosovës, Rexhep Selimi. Ata kanë një aktakuzë të përbashkët, kinse për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, akuza që i kanë mohuar.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, të njohura gjerësisht si Gjykata Speciale, janë themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe janë pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por veprojnë me personel ndërkombëtar në Holandë.

PSD-ja mbështet protestën e kundër Gjykatës Speciale: UÇK-ja nuk mund të gjykohet

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryetari i Partisë Socialdemokrate, Dardan Molliqaj, ka shprehur mbështetje për protestën e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër Gjykatës Speciale e cila do të mbahet më 7 gusht. Ai ka theksuar se besnikëria ndaj historisë së luftës çlirimtare është një nga sprovat

më të rëndësishme për gjeneratën e tanishme dhe kjo është një kauzë që kalon çdo llogari politike. Sipas Molliqajt, zhbërja e Gjykatës Speciale është mënyra e vetme për të sjellë drejtësi, pasi UÇK-ja nuk mund të gjykohet.

“Për ne kuptimi i drejtësisë është zhbërja e kësaj gjykate. Për ta

gjykuar UÇK-në, së pari duhet ta dyshojmë. Asnjë lloj verdikti që e supozon UÇK-në si të fajshme nuk sjellë drejtësi, pavarësisht përmbajtjes përfundimtare të tij. Sepse UÇK nuk mund të gjykohet. Ajo është kushti dhe mundësia për të pasur drejtësi në të ardhmen”, ka thënë Molliqaj.





KOSOVA NË ‘GJENDJE TË JASHTËZAKONSHME TË PASHPALLUR’

Njohës të çështjeve politike dhe monitorues të punës së Kuvendit kanë vlerësuar se shteti i Kosovës është në gjendje të jashtëzakonshme të pashpallur. Sipas tyre, kjo gjendje është pasojë e dështimit të deputetëve për ta përmbyllur konstituimin e Kuvendit deri më 26 korrik, ashtu siç kishte kërkuar Gjykata Kushtetuese. Ndërsa Ambasada e ShBA-së ka vlerësuar se ngërçi politik është duke rrezikuar integritetin e institucioneve të Kosovës. Në këtë kontekst, kjo ambasadë u ka bërë thirrje liderëve politikë të punojnë për të arritur një marrëveshje për konstituimin e Kuvendit

PRISHTINË, 29 KORRIK - Shteti i Kosovës është në gjendje të jashtëzakonshme të pashpallur. Kështu e ka përshkruar situatën institucionale në Kosovë, politologu Dritëro Arifi, profesor në Kolegjin UBT në Prishtinë. Sipas tij, kjo gjendje është pasojë e dështimit të deputetëve të Kuvendit të Kosovës për ta përmbyllur konstituimin e këtij institucioni deri më 26 korrik. Kjo datë shënon skadimin e afatit prej 30-ditësh të caktuar nga Gjykata Kushtetuese për deputetët e Kuvendit, të cilëve, sipas një vendimi të po kësaj gjykate të publikuar më 24 korrik, u ndalohej të ndërmarin çdo vendim apo veprim për konstituimin e Kuvendit nga data 27 korrik e deri më 8 gusht. Politologu Arifi ka rikujtuar se Kosova është shtet parlamentar dhe, përderisa Kuvendi i Kosovës

është institucion që ratifikon çdo ligj vendor dhe marrëveshje ndërkombëtare si dhe mbikëqyr institucionet e tjera të shtetit, mosfunksionimi i tij e çon vendin në një situatë problematike. “Shumica e të gjitha institucioneve relevante, me të cilat funksionon një shtet, sidomos një Republikë parlamentare – varen kryesisht nga Kuvendi. Pra, pa votat e Kuvendit nuk funksionon asgjë... Shteti i Kosovës është në gjendje të jashtëzakonshme, veçse se nuk është e shpallur. Është faktike”, ka thënë Arifi në një bisedë me “Radion Evropa e Lirë”.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, gjendjen e jashtëzakonshme mund ta shpallë presidenti i vendit, në rast se: ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes; ka rrezik të brendshëm ndaj rendit

kushtetues ose sigurisë publike; ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij. “Radio Evropa e Lirë” i është drejtuar Zyrës së Presidentes së Kosovës, nëse presidentja Vjosa Osmani konsideron se vendi po hyn në një fazë të mosfunksionimit institucional dhe rrezikohet e situatës aktuale. Deri në publikimin e artikullit, ky institucion nuk ka kthyer përgjigje.

Situatë “pa shtegdalje?”

Nga Instituti Demokratik i Kosovës sqarojnë se Kuvendi i Kosovës është gjeneratori kryesor që vë në lëvizje aktivitetin shtetëror, duke mbikëqyrur llogaridhënien e ekzekutivit, agjencive të pavarura dhe mekanizmave të tjerë, si dhe duke miratuar ligje dhe duke ratifikuar marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare. Vullneti Bugaoku nga ky institut ka theksuar se përderisa Kuvendi mbetet i pakonstituuar, shteti i Kosovës është praktikisht në një bllokadë institucionale dhe aktualisht pa shtegdalje. “Si pasojë e moskonstituimit të Kuvendit, shumë çështje mbesin pezull. Pa pasur një konstituim të Kuvendit, normalisht që edhe shteti nuk mund të veprojë dhe funksionojë në mënyrë normale dhe në mënyrë të plotë, në

kuptimin e ushtrimit të përgjegjësi dhe funksioneve të secilit funksionar, por edhe të secilit institucion”, ka thënë Bugaoku. Bllokada institucionale aktuale, sipas vëzhguesve të situatës politike në vend, tashmë po e përballë vendin me një varg pasojash. Përplasjet politike, vlerësojnë ata, tashmë po dëmtojnë imazhin e Kosovës në botë, duke e paraqitur si një vend që nuk ka stabilitet politik. Gjithashtu, pa Kuvend të konstituuar, që do të ratifikonte marrëveshjet ndërkombëtare, Kosova ende nuk ka arritur të marrë para-financimin nga fondi prej rreth 880 milionë eurosh nga Plani i Rritjes i Bashkimit Evropian, si dhe 90 milionë euro nga Banka Botërore.

“Shteti në pauzë”



Aktualisht shteti i Kosovës “është në pauzë” dhe nuk ka ndonjë sinjal se situata mund të dalë nga bllokada, ka thënë Bugaoku për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas tij, në mungesë të një Kuvendi të konstituuar, Qeveria në detyrë e Kosovës, e cila ka kompetenca të kufizuara, aktualisht nuk ka kujt t’i përgjigjet apo t’i raportojë. “Kur nuk ka Kuvend, nuk mund të formohet një qeveri e re dhe legjitime. Rrjedhimisht, shtohen mundësitë që kjo që është tani [Qeveria në detyrë] të prodhojë

vendime të kundërligjshme dhe jokushtetuese, si dhe të krijojë një lloj situatë kaotike për sa i përket zbatimit të kushtetutshmërisë, por edhe ligjshmërisë në vend”, ka theksuar Bugaoku.

Të paparashikueshme e sheh situatën politologu Arifi. Sipas tij, moskonstituimi i Kuvendit për shkak të përplasjeve politike, e ka futur vendin në situatë të pakuptueshme juridike, në të cilën, siç thotë ai, institucionet janë pa mbikëqyrje legjitime. “Përveç presidentes që ka një legjitimitet, madje shumë të cunuar, sepse presidentja zgjidhet prej Kuvendit...Pra, absurditet në vete. I vetmi institucion ku jepet llogaridhënia është Parlamenti, ndërkajq ne nuk kemi Parlament”, ka thënë Arifi.

Vëzhguesit e zhvillimeve politike në Kosovë, tashmë janë në pritje të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, që pritet të sqarojë rrugën drejt konstituimit të Kuvendit pas 8 gushtit. Lidhur me moskonstituimin e Kuvendit ka reaguar Ambasada e ShBA-së në Kosovë. Ajo u ka thënë medieve vendore se ngërçi politik po vonon progresin e aspiratave të Kosovës dhe po rrezikon integritetin e institucioneve të Kosovës, si dhe u ka bërë thirrje liderëve politikë që të punojnë për të arritur një marrëveshje për konstituimin e organit ligjvënës.

FSK-ja ME LEJEN E KFOR-it PËRFSHIHET NË OPERACIONIN E KËRKIMIT NË UJMAN



PRISHTINË, 29 KORRIK - Pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), në bashkërendim me KFOR-in, kanë nisur operacionin e kërkimit në Liqenin e Ujmanit në veri të Kosovës, pasi dy ditë më parë nga njëra nga urat e këtij liqeni dyshohet se një person ka kërcyer dhe nuk ka dalë më nga uji. Pas kërkimeve disa orëshe, trupi i pajetë i viktimës është është gjetur nga njësitet e FSK-së. Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë se FSK-ja është angazhuar në mbështetje të autoriteteve civile për kërkimin e trupit të një mërgimtari i cili ka kërcyer nga ura në Liqenin e Ujmanit. “Forca e Sigurisë së Kosovës në kuadër të detyrave të saj thelbësore ka

edhe mbështetjen e autoriteteve civile. Në këtë aspekt në bashkëpunim me Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave, Policinë e Kosovës dhe bashkërendim me KFOR, ekipet e specializuara të FSK-së kanë filluar operacionin e kërkimit në Liqenin e Ujmanit me synimin që sa më shpejt të nxirret trupi i mërgimtarit dhe t’i lehtësohet dhimbja familjes”, ka shkruar Maqedonci në “Facebook”. Ndërsa në një prononcim për medie në Ujman, drejtori ekzekutiv i Agjencisë për Menaxhimin Emergjent, Genc Metaj, ka thënë se kjo agjenci një ditë më parë ka parashtruar kërkesën për angazhimin e FSK-së në operacionin e kërkimit. Dislokimi i FSK-së në veri të

vendit është i mundur vetëm me pëlqimin paraprak të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR, bazuar në zotimin e vitit 2013 nga Qeveria e Kosovës ndaj NATO-s. Ky angazhim, i dhënë përmes një letre nga ish-kryeministri Hashim Thaçi drejtuar sekretarit të atëhershëm të NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, mbetet në fuqi edhe sot pavarësisht prej ndryshimeve në mandatin e FSK-së.

KFOR-i: Operacioni zhvillohet nën kushte specifike

Nga misioni i KFOR-it kanë konfirmuar se komandanti i

saj, gjeneralmajor Enrico Barduani, ka autorizuar FSK-në të dislokojë ekipe të kërkim-shpëtimit në zonën e liqenit të Ujmanit. Në njoftimin e KFOR-it është thënë se autorizimi është dhënë për arsye humanitare, në përputhje të plotë me kompetencat e komandantit të KFOR-it. “Operacioni zhvillohet nën kushte specifike të vendosura nga KFOR-i, i cili gjithashtu do të sigurojë mbarëvajtjen e tij. Angazhimi i FSK-së në këtë rast është në përputhje me mandatin e saj fillestar, që përfshin ndihmë për komunitetet lokale në raste katastrofash natyrore dhe operacione të kërkim-shpëtimit”, ka njoftuar KFOR-i.

Një 33-vjeçar dyshohet se ka kërcyer nga ura në Ujman pasditen e së dielës së kaluar. Ujmani gjendet në Zubin Potok, një nga katër komunat në veri të Kosovës të banuara me shumicë serbe. Deri para gjetjes së viktimës operacionet e kërkim-shpëtimit janë realizuar nga Policia e Kosovës, Shoqata e Kosovës për Kërkim dhe Shpëtim si dhe nga zjarrfikësit. Ndërkaq, pas këtij rasti, Policia e Kosovës u ka bërë thirrje qytetarëve të mos kërcejnë nga ura në Ujman. FSK-ja është në proces të transformimit në ushtri pas ndryshimeve ligjore të miratuara. Ky proces pritet të përmbyllet më 2028.

HOTI: KUSHTETUESJA DUHET T’I ZGJIDHË PROBLEMET POLITIKE QË I KA KRIJUAR VETË

PRISHTINË, 29 KORRIK - Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, ka thënë se Gjykata Kushtetuese nuk ka nevojë dhe nuk duhet ta zgjidhë çdo problem politik. Sipas tij, ajo duhet të zgjidhë, para së gjithash, ato probleme politike që i ka krijuar vetë. “Me aktgjykimin e vitit 2014, i cili citohet edhe në aktgjykimin e datës 26 qershor 2025, duke ia njohur partisë së parë të dalë nga zgjedhjet të drejtën absolute për propozimin e kandidatit për kryetar të Kuvendit, Gjykata Kushtetuese e ka kurthuar procesin e konstituimit të Kuvendit duke shkelur dy parimet fundamentale të demokracive parlamentare. E para, ka shkelur parimin e dominimit të shumicës. Si rregull bazë, në demokracitë parlamentare, duke vepruar në kuadër të frymës kushtetuese, shumica gjithmonë vendos. Aktgjykimi i vitit 2014 e ka shkelur këtë parim, duke ia dhënë të drejtën vetëm partisë së parë të propozojë kryetarin e Kuvendit,

pavarësisht se ajo parti nuk e ka siguruar shumicën parlamentare. Si rezultat, mund të jenë 80 deputetë, mjaftueshëm për të ndryshuar edhe Kushtetutën, që mbështesin një kandidat të caktuar, por e kanë të pamundur të votojnë pa vullnetin e pakicës për të propozuar atë kandidat”, ka shkruar Hoti në “Facebook”. Hoti ka theksuar se aktgjykimi i vitit 2014 ka shkelur parimin kushtetues, sipas të cilit, mandati i deputetit është i lirë dhe i pakushtëzuar. “E dyta, aktgjykimi i vitit 2014 ka shkelur parimin kushtetues sipas të cilit mandati i deputetit është i lirë dhe i pakushtëzuar. Duke ia njohur të drejtën absolute partisë së parë për të propozuar kandidatin për kryetar të Kuvendit, Gjykata Kushtetuese e ka cenuar këtë parim kushtetues. Deputeti nuk është i lirë në ushtrimin e mandatit pasi mund të votojë vetëm propozimin që vjen nga partia e parë. Kjo krizë politike, e krijuar nga Gjykata Kushtetuese, duhet



të zgjidhet për të dalë nga ngërçi aktual politik, si dhe për të parandaluar situata të ngjashme në të ardhmen”, ka shkruar Hoti, duke se Kushtetuesja duhet ta kthejë seancën në pikën e rendit të ditës ku është ndryshuar nga kryesuesi i seancës konstituive të Kuvendit, Avni Dehari. “Zgjidhja është e qartë: sikurse me rastin e zgjedhjes së

Qeverisë, i pari që del nga zgjedhjet – apo siç njihet, fituesi relativ – e ka të drejtën e propozimit të kandidatit për kryetar të Kuvendit, e më vonë edhe të mandatarit për formimin e Qeverisë, në mënyrë automatike. Por kjo e drejtë automatike duhet të jetë e kufizuar në kohë. Pas një afati të arsyeshëm kohor, siç është përcaktuar në rastin e zgjedhjes

së Qeverisë, e drejta i kalon kujtdo që arrin të formojë shumicën parlamentare. Një zgjidhje e tillë është: (i) brenda frymës kushtetuese, (ii) në përputhje me parimet elementare të funksionimit të demokracive parlamentare, si dhe (iii) në linjë me praktikën e shumë vendeve evropiane. Edhe nëse, siç po komentohet këto ditë nga disa njohës të çështjeve kushtetuese, Gjykata Kushtetuese vendos ta kthejë seancën konstituive në datën kur, në mënyrë jokushtetuese dhe arbitrare, është ndërruar rendi i ditës nga ana e Kryesuesit të përkohshëm të Kuvendit, sërish duhet të zbatohet parimi bazë kushtetues: shumica vendos. Fituesi relativ i zgjedhjeve mund ta shfrytëzojë të drejtën e tij brenda një afati të arsyeshëm kohor, pas të cilit afat e drejta i kalon kujtdo që arrin të formojë shumicën në Kuvend. Vetëm një zgjidhje e tillë respekton parimin e shumicës dhe mandatin e pakushtëzuar e të lirë të deputetit”, ka shkruar Hoti.

Radoniqi fton mërgatën të regjistrohet për votim me postë

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryesuesi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Kreshnik Radoniqi, u është adresuar me një videomesazh të gjithë shtetasve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit për t'i informuar për të drejtën dhe mundësinë e tyre për t'u regjistruar votues jashtë vendit për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Periudha për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës ka nisur më 23 korrik dhe do të zgjasë deri më 29 gusht. "Për të

votuar nga jashtë Kosovës është e domosdoshme të regjistroheni brenda këtij afati përmes platformës së KQZ-së", ka thënë Radoniqi.

Në emër të KQZ-së, Radoniqi i ka ftuar të gjithë shtetasit e Kosovës të bëhen pjesë e procesit zgjedhor, duke thënë se "pjesëmarrja e juaj në zgjedhje është e rëndësishme dhe vota juaj ndikon drejtpërdrejtë në të ardhmen e komunës tuaj". Vetëm shtetasit e Kosovës që do të

regjistrohen gjatë kësaj periudhe do të mund të votojnë përmes postës në periudhën e cila do të fillojë më 17 shtator dhe do të përmbyllet më 11 tetor 2025. Për dallim nga zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, në Zgjedhjet Lokale votimi jashtë vendit realizohet vetëm përmes postës, pasi në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme përcaktohet se votimi në përfaqësi diplomatike nuk aplikohet në këto zgjedhje.



KRASNIQI: KOMUNAT QË UDHËHIQEN NGA PDK-ja, KAMPIONE TË TRANSPARENCËS



Prishtinë, 29 korrik - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, është mburrur me suksesin e kryetarëve të komunave që vijnë nga ky subjekt politik. Pesë komuna që udhëhiqen nga PDK-ja kanë arritur pikët maksimale

bazuar në raportin e GAP-it për transparencën buxhetore e që janë: Kaçaniku, Mitrovica e Jugut, Prizreni, Skenderaj dhe Vushtrria. Edhe dy komuna të tjera, siç janë Drenasi dhe Hani i Elezit, janë në mesin e më të mirave me 95 pikë. "Nga tetë


komunat me shumicë shqiptare që udhëhiqen nga PDK, pesë prej tyre, Kaçaniku, Mitrovica e Jugut, Prizreni, Skenderaj dhe Vushtrria, kanë arritur vlerësimin maksimal prej 100 pikësh nga Instituti GAP për transparencën buxhetore në vitin 2024.

Drenasi dhe Hani i Elezit gjithashtu janë ndër më të mirat, me nga 95 pikë secila. Në total, komunat tona janë kampione absolute të transparencës dhe të menaxhimit të parasë publike. Ky është standardi që PDK-ja sjell në qeverisje,

kudo ku merr përgjegjësi. Më 12 tetor, do të vazhdojmë punën për fitoren edhe në komuna të tjera, që sa më shumë qytetarëve t'u shërbejmë me punë, transparencë, zhvillim dhe shumë dashuri", ka theksuar Krasniqi.

Figura 1. Figura 1. Indeksi i transparencës buxhetore të komunave 2024

Burimi: Instituti GAP



Tahiri ia paraqet Edi Ramës një plan reformash



TIRANË, 29 KORRIK - Ish-deputeti i AAK-së dhe nënkryetari i kësaj partie, Besnik Tahiri, ka njoftuar për një takim me kryeministrin shqiptar Edi Rama në Kryeministrinë në Tiranë. Ai ka thënë se, krahas përgëzimeve për "arritjet historike" të Shqipërisë drejt BE-së, Ramës ia ka paraqitur edhe një "plan reformash" për katër vitet e ardhshme të qeverisjes. "Pata kënaqësinë të takohem me kryeministrin Edi Rama, të cilin e

përgëzoja për arritjet historike të Shqipërisë në rrugën e integritit evropian, duke u bërë vendi i parë në Ballkanin Perëndimor që avancoi në këtë proces. Gjatë takimit, i prezantova idenë e një plani të avancuar reformash për katër vitet e ardhshme RAMP4 (Rama's Marshal Plan 4 Albania), që në thelb ka për qëllim reformimin strukturor të sistemit të qeverisjes në të dy nivelet, qendror dhe vendor",

ka thënë ai. Më tutje, Tahiri ka thënë se e ka informuar Ramën edhe për një konferencë ndërkombëtare në Tiranë. "Po ashtu, e informova për iniciativën time për Konferencën Ndërkombëtare për Qeverisje, që do të mbahet së shpejti në Tiranë, që në fokus do të ketë trendet globale të menaxhimit publik, reformat, inovacionin institucional dhe qasjen moderne në qeverisje", ka thënë Tahiri.

I LIRË NË BURG, TË BURGOSUR NË LIRI!



Shkruan: Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Intervistë e jashtëzakonshme e Hashim Thaçit: Hashim Thaçi është figura më mbresëlënëse dhe përcaktuese në historinë e re të Kosovës dhe shqiptarëve. Që nga vitet e '80-a të shekullit të kaluar nuk ka proces nëpër të cilin ka kaluar Kosova dhe shqiptarët (jo vetëm në Kosovë) e që Hashim Thaçi të mos jetë në epiqendrën apo vet qendra e zhvillimeve që përfunduan me luftën e lavdishme të së lavdishmes Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) me komandantin politik, të pavdekshmin Bacë Adem Demaçi dhe Legjendarin Adem Jashari. Hashim Thaçi ishte alfa dhe omega e Lëvizjes Studentore që ishte spiritus movens e rezistencës aktive dhe ushtarake. Ishte indi ndërlihdës i organizimit në diasporë dhe aktiviteteteve të ilegales në Kosovë. Para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, isha i pranishëm si monitorues, si pjesë e grupit të Adem Jasharit u dënua në mungesë me 15 vjet burgim. Ishte pjesë fundamentale dhe e pazëvendësueshme e luftës së UÇK-së deri në çlirim dhe adresa kryesore e komunikimit politik me faktorin ndërkombëtar. Kundërshtarët dhe sabotuesit e luftës, dezertorët dhe mohuesit e lirisë e akuzonin se luftën e ka bërë nga “shtabi operativ i Rognerit” në Tiranë e që e vërteta ishte krejtësisht e kundërt. Një atdhetar i jashtëzakonshëm, njeri i mrekullueshëm dhe shqiptar i madh, ish-i burgosur politik, tash prehet në përjetësi bashkë ne shokët e idealit, Bacë Adem Demaçi, Dr. Hafir Shala, Fehmi dhe Xhevdet Lladrovci, Xhavit Haziri dhe të tjerë, i pavdekshmi Tahir Hani nga Veleshta e Strugës na tregonte se gjatë kalimeve të shpeshte nga Shqipëria në Kosovë, përmes Maqedonisë, Hashim Thaçi kishte kallashnikovin dhe dy bomba dore, i vendosur të mos dorëzohej i gjallë nëse do të përballej me forcat armike.

Koha e tranzicionit: Pasi i udhëhoqi me mjeshtëri dhe saktësi prej filigrani bisedimet e Rambujesë, me taktikën tërhiq e mos e këput, nxori më të mirën e mundshme kur e dëgjoi këshillën e Bacë Adem Demaçit që të mos e nënshkruaj marrëveshjen pa garanci të

forta. Thonë se trimave iu prinë edhe fati! Fati ishte se Serbia nuk pranoi ta nënshkruante këtë marrëveshje duke bërë llogari të gabuara. Hashim Thaçi bëri mirë që nuk ua dorëzoi rolin udhëheqës të tjerëve; Rugova ishte tepër i butë për vendime të rënda, Qosja kishte qëndrim oportunist dhe të luhatshëm, ndërsa po të varej nga Veton Surroi për pesë minuta do të kthehej Jugosllavia dhe Serbia në Kosovë, përmes UJD-it. Kam qenë bashkë ne Bacën Adem në shumicën e bisedave telefonike që i bënte Baca me Hashim Thaçin përmes telefonit satelitor dhe jam i informuar shumë mirë. Hashim Thaçi ishte nën presion të madh nga rryma projugosllave e delegacionit, nga ndërkombëtarët dhe nga autoritetet mercenare të Shqipërisë për ta nënshkruar, pa kushte këtë marrëveshje. Blerja e kohës nga Thaçi e forcoi pozicionin negociues të Kosovës. E udhëhoqi procesin e demilitarizimit të UÇK-së që kushtëzohej nga ndërkombëtarët, si kusht drejt shtetësisë. Ishte dominues në bisedimet e Vjenës ku bëri lëshime taktike, për një fitore strategjike - shtetin e Kosovës. Kur e lexoi Deklaratën e Pavarësisë ia panë për të madhe pse nuk ia lejojnë këtë Fatmir Sejdiut që ishte president apo për ta zënë ngushtë pse këtë nuk e bëri Baca Adem Demaçi. Po, ma gjeni një rast të vetëm në botë kur dikush ia dhuron tjetrit lavdinë e fituar më shumë mund dhe sakrifica për ta bërë këtë Hashim Thaçi i cili, jo se nuk e pëlqen popullaritetin dhe lavdinë! Pas shpalljes së pavarësisë, Hashim Thaçi si KM, një kohë ministër për Punë të Jashtme, deputet dhe president, më shumë sukses arriti ta pajisë Kosovën me letërnjoftim ndërkombëtar përmes më shumë se 115 njohjeve dhe anëtarësimit në organizata ndërkombëtare. Thuaja e zhduku kufirin Kosovë - Shqipëri, kontribuoi shumë për të drejtat politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të shqiptarëve në Maqedoni të Veriut, Luginë të Preshevës dhe Mal të Zi.

Gjykata Speciale Raciste: Një politikan me mentalitet dhe sjellje prej injoranti dhe mediokriteti nuk ka kapacitet të marrë vendime të mëdha për kombin dhe shtetin shkaku se ia mund lakmia dhe interesi personal, familjar dhe grupor. Vetëm ai që ka vetëdije dhe përgjegjshmëri prej burrështetasi është në gjendje të marrë vendime të dobishme për kombin dhe shtetin edhe nëse janë kundër tyre e kryesisht janë kundër tyre. I tillë ishte Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi dhe Kadri



Veseli duke mbrojtur interesin kombëtar dhe shtetëror përmes vetëmohimit dhe sakrifikimit personal. Rexhep Selimi ishte kundër GjSR-së mirëpo fatin e ka bashkërenditur me ata që e votuan këtë gjykatë... në GjSR në Hagë. Në jetë e sidomos në politikë, i mençuri dhe i urti kërkon vetëm atë që “i takon Cezarit”, atë që mund ta ketë në bazë të investimeve që i ka bërë. Ndërkaq ata që nuk kanë bërë asgjë për komb dhe popull, vuajnë nga nevoja e domosdoshmërisë së kompensimit për atë që nuk e kanë njerëzoren dhe patriotizmin. Kërkesat i kanë maksimale kurse qëllimin përfundimtar e kanë një pjatë për ta lëpirë dhe një asht për ta gërryer. Aq është investimi i tyre! Një lojtar i mirë i shahut e sakrifikon mbretëreshën për ta fituar lojën. Një patriot dhe burrështetas i mençur e sakrifikon veten për kombin dhe shtetin. Një lojtar i keq i shahut e jep mbretëreshën për ta fituar figurën e kalit mbi të cilin do të hipë si Don Kishoti mbi Rosinantin. Don kishotët kosovarë nuk dinë çka është shteti apo kombi andaj i bëjnë rrush e kumbulla.

Çka na mësoi intervista e Hashim Thaçit?: Asgjë të veçantë për njohësit e rrethanave të burgut dhe psikologjinë e një të burgosuri që ka një qëllim për të

mbrojtur, dinjitet dhe përgjegjësi ndaj këtij qëllimi dhe dinjiteti. Historikisht, që nga Greqia antike, perandoria Romake e deri më sot dihet se veprat më të mëdha shkencore, letrare, artistike, kulturore dhe të tjera janë shkruar ose në burg ose gjatë internimit, brenda dhe jashtë vendit. Në këtë nënqiell e shoh edhe intervistën e Hashim Thaçit. Në jetën time kam takuar tre personalitete që për fatin e tyre të pësuar nga burgu i gjatë apo internimi nuk e fajësojnë askënd, nuk e mallkojnë askënd dhe nuk kërkojnë përgjegjësi nga askush për faktin se kishin përqafuar filozofinë stoike dhe mentalitetin e Prometheut. Ata ishin:

1. Bacë Adem Demaçi që kaloi afërsisht 30 vjet në llogoret e ish-Jugosllavisë dhe Serbisë,
2. Kozara Kati, që është në parajsë bashkë me Bacën Adem, kishte kaluar mbi 23 vjet internim dhe burg në llogoret e Enver Hoxhës dhe,
3. Hashim Thaçi që po mbahet peng që 5 vjet në Gjykatën Raciste Speciale në Hagë.

Në intervistën e Hashim Thaçit nuk gjeni mlllef, hatërmбетje apo përpjekje për hakmarrje ndaj askujt, llaskuqëve politikë të vendit e as ndaj kriminelëve ndërkombëtarë. As ndaj halabakëve e as ndaj prostitutave mercenare mediale. As ndaj atyre që e

fyejnë personalisht dhe familjarisht në kundërshtim me moralin njerëzor dhe traditën shqiptare. Ishte një intervistë e njeriut prej mishit dhe gjakut, emocionale ku kërkohej emocionet, e ftohtë si akulli kur mbrohej interesi kombëtar dhe shtetëror. Për ata që shfaqin dyshime se këto fjalë nuk janë të Hashimit e them se asgjë nuk kuptojnë nga jeta e burgut. Kam qenë afërsisht 9 vjet në burg, mbi 5 vjet në izolim. Nëse një i burgosur qëndron i fortë moralisht dhe shpirtërisht, nëse e mirëmban veten fizikisht dhe që është shumë me rëndësi nëse e kalon kohën duke lexuar, pesë vjet aq sa është Hashim Thaçi në burg janë të barasvlefshme me përfundimin e studimeve me sukses shembullorë në Oxford apo Cambridge. Më së paku. Intervista e Hashim Thaçit nga burgu i Hagës e vërtetojnë atë që e shkrova më lart se humbja e përkohshme e lirisë në asnjë mënyrë nuk është pengesë gjatë ecjes drejt caktit për të cilin jeni angazhuar dhe sakrifikuar gjatë tërë jetës, përkundrazi e përshpejton arritjen e caktit, nëse jo për të burgosurin personalisht, për njerëzimin pa asnjë dyshim! Hashim Thaçi edhe në burg është më i lirë se këta që janë në liri por që mendjen, zemrën dhe shpirtin e kanë të robëruar nga lakmia, smira dhe urrejtja! Fali o Zot ndonëse e dinë çka bëjnë!

Përrurimi i tri ndërtesave sociale në Skenderaj, Rizvanolli: Ky investim përmirëson jetën e 100 familjeve

SKENDERAJ, 29 KORRIK - Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë ka përruruar të martën përrfundimin e punimeve në tri ndërtesa sociale shumëbanesore në Skenderaj, nga e cila kanë përrfituar 100 familje në nevojë. Me këtë rast, ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka deklaruar se investimi në energji eficiente është duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së banorëve.

“Përrurojmë përrfundimin e investimeve me eficiencë të energjisë në tri ndërtesa, banesa sociale shumëbanesore, të cilat i presin 100 familje të Skenderajt në kushte të vështira, duke përrfshirë këtu edhe përrfitues të asistencës sociale, familje të dëshmorëve dhe 30 gra nëna vetë-ushqyese. Ky është pjesë e një programi më të gjerë në nivel vendi, ku tashmë është duke u punuar edhe në 12 komuna të

tjera, në renovimin total të 28 ndërtesave sociale me një vlerë totale prej 6 milionë euro. Ndërsa investimi këtu është rreth 693 mijë euro. Këto investime po realizohen me përrkrahje financiare të BE-së në masë 90 për qind dhe bashkëfinancim të komunave prej 10 për qind”, ka thënë Rizvanolli. Ndërsa përrfaqësuesi i Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Alessandro Bianciardi, ka theksuar rëndësinë e

përrkrahjes që BE-ja po i jep Kosovës në përrballimin e krizës energjetike. Ndërkaq kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, është shprehur i kënaqur për bashkëpunimin dhe suksesin e projektit për renovimin e ndërtesave sociale. “Jam jashtëzakonisht i kënaqur që jemi komuna e parë që po implementon dhe finalizon një projekt kaq të rëndësishëm”, ka thënë Nura. Projekti në fjalë është pjesë e



një programi më të gjerë që përrfshin renovimin e 28 ndërtesave në 13 komuna të Kosovës, me një buxhet total prej 6 milionë eurosh.

GËRXXHALIU: PARAMETRAT EKONOMIKË NË KOSOVË JANË SHQETËSUES

PRISHTINË, 29 KORRIK - Moskonstituimi i Kuvendit të Kosovës dhe mosformimi i qeverisë që nga zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 është duke shkaktuar dëme të mëdha në aspektin ekonomik, ka vlerësuar njohësi i ekonomisë, Safet Gërxhaliu. Ai për “Ekonomia Online” ka thënë se kjo situatë është një prej periudhave më të errëta në historinë e re të Kosovës. “Është duke ikur kapitali kosovar dhe është duke u investuar në vendet e rajonit e më gjerë. Kohët e fundit, para shtrenjtimit të energjisë elektrike kemi pasur shtim masiv të kompanive, të cilat e kanë bartur prodhimin në vendet e rajonit. Në këtë drejtim nga mungesa e institucioneve ne nuk kemi ratifikim të marrëveshjeve ndërkombëtare. Dëmet aktuale janë pothuajse një miliard e 200 milionë euro, duke përrfshirë afër 830 milionë euro që kanë të bëjnë me fondet që ndërlidhën me agjendën për reformat e BE-së dhe me projektet e financuara nga ShBA-në. Dhe prej tyre shtohet edhe fakti që kemi dy marrëveshje të paratifikuara me Bankën Botërore 230 milionë euro dhe një që është 90 milionë euro dhe ato janë të ngrira dhe paramendoni se cilat janë dëmet që po i shkaktohen Kosovës. Sot për Kosovën dominon një heshtje në politikën evropiane dhe kjo është më e keqja që mund t'i ndodh Kosovës. Prandaj, besoj se në qoftë se dikush mendon të bëjë më tepër për Kosovën, është koha të kuptojmë dy termet: termin sakrificë dhe kompromis që për



shtet dhe për ardhmërinë e qytetarëve të bëjë më tepër dhe jo lufta për pushtet të jetë dominante”, ka thënë ai. Gërxhaliu ka thënë se armiqhtë më të mëdhenj të Kosovës nuk e kanë paraparë që vendi ynë do të jetë në një situatë të tillë në të cilën është tani, në këtë kohë të turbulencave globale dhe botërore, ku “definitivisht kriza

edhe politike, ekonomike dhe gjeostrategjike është në lëvizje dhe një shtet i ri, siç është Kosova të ketë komoditetin apo luksin të eksperimentojë me shtet në këtë mënyrë, është më e keqja që mund t'i ndodh Kosovës”. “Që nga shkurti i vitit 2025 ne nuk kemi arritur të zgjedhim kryetarin e Kuvendit që është dobësia më e madhe dhe në këtë

drejtim pasojat nga ky eksperiment i qëllimshëm politik në dëm të Kosovës do të jenë të shumta. Janë vërtet shqetësuese në aspektin gjeostrategjik, janë shkatërruese në aspektin politik, janë të dëmshme në aspektin ekonomik, janë të ngadalësuara në aspektin integruar, por duhet të analizohen edhe në aspektin

psikologjik dhe emocional. Si e ndiejnë veten sot qytetarët e Kosovës të jesh nën masa apo sanksione të BE-së dhe të kesh këtë komoditet për të eksperimentuar me shtet dhe për të luftuar vetëm për pushtet? Është turp i madh”, ka thënë ai. Më tutje, Gërxhaliu ka theksuar se në vend se të kemi institucione, ta promovojmë Kosovën, zhvillojmë ekonominë dhe t'i shpallim luftë inflacionit, partitë politike janë duke u marrë me luftën për pushtet. “Duhet të kuptohet e vërteta që indikatorët apo parametrat ekonomikë në Kosovë janë mjaft shqetësues. Në rend të parë duhet të kuptohet që nuk mund të ketë prosperitet dhe zhvillim ekonomik pa stabilitet politik. Stabiliteti politik në Kosovë varet nga dy dimensionet: nga aspekti i brendshëm dhe jashtëm. Aspekti i brendshëm: vetë fakti që jemi duke funksionuar me rënie të lirë apo me inerci të kohës pa institucione është e shqetësuese, e para. E dyta është aspekti jashtëm kur kemi jo vetëm pesë shtete të BE-së që nuk e njohin Kosovën, por i kemi edhe sanksionet, të cilat po e ngufatin perspektivën zhvillimore të Kosovës dhe definitivisht vendet e zhvilluara bëjnë çmos për t'ju afruar Amerikës dhe Evropës dhe Kosova po bën çmos që t'i largohet Amerikës dhe Evropës. Në këtë drejtim kemi rritje të importeve dhe turrje të eksporteve, kemi ikje të trefishtë nga Kosova, ku jo vetëm qytetarët e papunë por po ikin edhe ata që kanë stabilitet”, ka thënë Gërxhaliu.

Murati: Nga ky muaj shërbyesve publikë u shtohen edhe 55 euro në paga

Prishtinë, 29 korrik - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar se “nga ky muaj e tutje shërbyesit publikë që punojnë në organizata buxhetore do të marrin pagën me rritje prej 55 eurosh shtesë”. “Rritja e këtij muaji e kompletton rritjen e paraparë sivjet prej 110 eurove për secilin punonjës, e cila

zbatohet në dy faza nga 55 euro - faza e parë nga janari 2025 dhe faza e dytë nga korriku 2025”, ka shkruar Murati në “Facebook”. Më tutje, Murati ka thënë se kjo “përbën rritjen e katërt të pagave në sektorin publik prejse kemi marrë mandatin, gjë që na bën qeverinë e vetme që ka rritur pagat 4 herë

brenda mandatit”. “Rritja e parë në shkurt 2023 - hyrja në fuqi e Ligjit të Pagave. Rritja e dytë në janar 2024 - rritja e koeficientit nga 105 në 110. Rritja e tretë në janar 2025 - rritja prej 55 eurosh në muaj për të gjithë punonjësit. Rritja e katërt në korrik 2025 - rritja prej 55 eurosh në muaj për të gjithë punonjësit”, ka shkruar Murati.



VERA E MINI DOLLARIT

Jo tarifatat doganore. Qëllimi i vërtetë i Donald Trump është të dobësojë në mënyrë të qëndrueshme monedhën amerikane kundrejt euros, për të nxitur eksportet e tij në Evropë. Edhe “lufta” kundër Kinës dhe reduktimi i angazhimit ushtarak janë pjesë e këtij plani

In God we trust. Për ta thjeshtësuar mund të thuhet: Zoti na ndihmoftë. E shtypin këtë fjali prej më shumë se 160 vitesh në kartëmonedhën një dollarëshe, e cila është, bashkë me flamurin, simboli i vërtetë i unitetit amerikan dhe gjithashtu njësi matëse e globit. Donald Trump dëshiron të ndryshojë rregullat e lojës: nga dollari që mat botën, në një botë të përshtatur sipas dollarit. Për këtë arsye po lufton globalizimin me goditje tarifash doganore për të rikthyer zonat e ndikimit, duke ua hequr rrogzin në këmbë kinezëve – kundërshtarët e vërtetë të tij – të cilët kanë përfituar shumë nga monedha amerikane dhe që kanë mbajtur barrën e rregullimit të transaksioneve ndërsa prodhonin në juanë.

Kthesa që kreu i MAGA (Make America Great Again) po i jep SHBA-ve është shprehur përmes tarifave doganore (kërcënime, tërheqje): kapitulli i fundit ka të bëjë me Evropën që supozohet të “përfitojë” nga një tarifë doganore shtesë prej 10%, por sfida e vërtetë është me dollarin. Stephen Miran, një ekonomist heretik, e ka përkufizuar kështu: për ta bërë Amerikën të madhe, nevojitet një dollar i dobët. Sipas tij, fakti që dollari është valuta rezervë e botës është një darë e dyfishtë: e mban atë vazhdimisht të mbivlerësuar dhe frenon eksportin e industrive amerikane. Prandaj, sipas tij, duke pasur një dollar më të dobët, do të rritet mirëqenia e atyre që jetojnë nga eksporti, sidomos ndaj Kinës: super amerikanët do të shesin më shumë automobila, çelik, produkte agro-ushqimore, modë dhe gjithçka tjetër, se më parë.

Në maj, bilanci tregtar ka pasur një deficit prej 71.5 miliardë dollarësh: eksportet ranë në 279 miliardë, ndërsa importet mbetën të qëndrueshme në 350.5 miliardë dollarë. Kjo do të thotë, deri në fund të vitit, një deficit tregtar prej një mijë miliardë dollarësh, më pak vende pune, më pak të ardhura fiskale dhe më shumë borxh. Për ta zgjidhur këtë, Miran thekson nevojën për një zhvlerësim të dollarit deri në 25 për qind, duke u mbështetur te fakti që për energji dhe shumë lëndë të para, Shtetet e Bashkuara kanë mjaftueshmëri.

Receta kundër skepticizmit të fituesve të çmimit Nobel po jep njëfarë rezultati: PBB-ja është në rritje me 3.8 për qind kundrejt parashikimeve prej 2.2 për qind, në qershor u krijuan 147 mijë vende të reja pune dhe inflacioni (falë pikërisht dollarit të dobët) mbetet i qëndrueshëm në 2.4 për qind, me Wall Street-in që thyen çdo rekord. Miran i sugjeron Trump-it – dhe kjo shpjegon



lëvizjet e presidentit amerikan në selinë e NATO-s – se superdollari është ndërtuar përmes rolit që Shtetet e Bashkuara kanë marrë si “rojtari i botës”: prandaj është e nevojshme që Amerika të reduktojë angazhimin e saj ushtarak.

Pas taksave doganore, pas deklarimit të paaftësisë për të paguar borxhet nga aleatët për mbrojtjen, pas zhvlerësimit të vazhdueshëm të dollarit, duhet të arrihet një marrëveshje, e cila përfshin edhe Kinën, për të rregulluar sistemin monetar global. Një “Bretton Woods 5.0”: ashtu si në vitin 1971 kur Nixon shpalli të pavarëshëm konvertimin e dollarit në ar, Trumpi me marrëveshjen e Mar-a-Lago do të donte të shpallte se dollari nuk është më monedha e botës.

Ka një precedent: është marrëveshja e Plaza-s – plot 40 vjet më parë – që Ronald Reagan e arriti me atëherë G5-en (Franca, Gjermania, Japonia, Britania e Madhe) për një zhvlerësim të dakordësuar të dollarit. Kundërshtimet ndaj kësaj strategjie janë të shumta. Nobelisti Paul Krugman e ka hedhur poshtë si një pamflet tezën e Miranit, të paraqitur në librin “Udhëzues për Ristrukturimin e Sistemit Global të Tregtisë” (User’s Guide to Restructuring the Global Trading System), duke thënë se nuk ka asnjë mundësi për një marrëveshje të ngjashme sot. Barry Eichengreen, në Financial Times, ka vërejtur: “Mbizotërimi i

pandërprerë i dollarit nuk është rastësi – Amerika vlen sa një e treta e PBB-së globale dhe rregullon transaksionet financiare – është forca reale e marrëdhënieve që kanë SHBA-të”.

Por Trumpi nuk heq dorë: siç tha njëherë në Zyrën Ovale duke qortuar Volodymyr Zelenskin: “Ti ke armët, unë kam kartat bankare”, që do të thotë fuqinë financiare.

Udhëheqësi i MAGA-s, sidoqoftë, ka nevojë për një Rezervë Federale të bindur, prandaj e kritikon Jerome Powell-in që drejton Bankën Qendrore (i ka mbetur edhe një vit mandat) sepse ndjek një kurs të kundërt me atë të Trump-it. Nëse plani për të rritur prodhimin amerikan përmes një dollari të dobët që nxit eksportin – dhe nëpërmjet kombinimit zhvlerësim + tarifa doganore për të frenuar importin – realizohet, presidenti amerikan ka nevojë për mbështetje për zhvillim përmes normave shumë të ulëta të interesit, të cilat do të stimulojnë konsumin dhe investimet e brendshme.

Dhe këtu ndodhemi në zemrën e “Trumponomics”. Me miratimin e “Big Beautiful Bill” (Buxheti Madhështor!), presidenti do të ulte taksat për shtresën e mesme – atë që u dëmtua nga rënia e industrisë në zonat e ashtuquajtura Rust Belt, ku dikur ndodheshin fabrikat e mëdha, të përshkruara nga JD Vance në “Elegjia Amerikane”, libri që i dha atij postin e zvpresidentit. Por borxhi publik ka kaluar tashmë

40 mijë miliardë dollarë! Trump ka nevojë të shesë bono (obligacione), dhe për këtë arsye Powell nuk do t’i ulë normat e interesit.

Por një tjetër ekonomist “heretik” dhe aleat i Trump-it, Peter Navarro, shpall: “Për taksat doganore dhe dollarin nuk ka negociatë, po ua faturojmë të tjerëve atë që për shumë kohë na është faturuar neve.”

Navarro për Elon Musk është një idiot dhe, për të thënë të vërtetën, ka disa sjellje të çuditshme: shkruan ese nën pseudonimin Ron Vara për të lavdëruar vetë studimet e tij. Megjithatë, një gjë amerikanët e kanë kuptuar mirë: “Vetëm kinezët mund të kthejnë një djep në një armë vdekjeprurëse, baterinë e një celulari në një copëz që të shpon zemrën.”

Prandaj America First është e bindur se mini-dollarit është arma vdekjeprurëse kundër rivalëve tregtarë dhe papunësisë. Zhvlerësimi i dollarit të gjelbër nuk ka sjellë probleme për pjesën tjetër të botës. Ai ka humbur rreth 13% ndaj euros që nga fillimi i vitit, dhe ky indeks është rritur pavarësisht tarifave doganore. Kina po përpaket të reagojë ndaj mini-dollarit duke zhvlerësuar renminbin, monedhën e saj që synon t’ua imponojë të gjitha vendeve të BRICS-it për të zhvilluar një mënyrë alternative pagese për lëndët e para (nga mineralet e rralla tek produktet bujqësore) në qarkun Afrikë – Amerikë Latine – Azia Juglindore – Rusi.

Por samiti i fundit para tre javësh në Brazilia dështoi keq: nuk ishin të pranishëm as Xi Jinping dhe as Putin.

Evropa dhe veçanërisht Banka Qendrore Evropiane, të pasigurta, qëndrojnë duke vëzhguar.

Nga Sintra, ku në fund të qershorit u mbledhën bankierët qendrorë, Christine Lagarde konfirmoi se për normat e interesit janë të mundshme ulje të mëtejshme sepse inflacioni po qëndron rreth 2%, por ajo duket e paaftë për të përballuar skenarin e ri të mini-dollarit, që ka vetëm një përparësi: bën evropianët të paguajnë më pak për naftën, gazin dhe lëndët e para, por u dëmton eksportet; kjo do të thotë të shkohet drejt deflacionit, drejt më pak vendeve të punës dhe më pak investimeve. Dhe gjithashtu më pak turistë.

Një ngadalësim i ciklit ekonomik tashmë është i dukshëm në Francë dhe Gjermani. Guvernatori i Bankës së Italisë, Fabio Panetta, propozon eurobonde për të përballuar shokun e tarifave dhe të mini-dollarit. Ideja është e njëjtë me atë që qarkullon në Komisionin e Ursula von der Leyen, për të përdorur pjesë të fondeve të PNRR për të zbutur goditjen ndaj prodhimit. Por deri tani BQE-ja nuk është treguar aspak e shqetësuar për të balancuar kursin euro-dollar, as për të pasur një politikë monetare.



Instrumenti kryesor për ta bërë këtë është ulja e normave të interesit, edhe me koston e rritjes së inflacionit, duke bindur edhe gjermanen kokëfortë Isabel Schnabel – që në Bankën Qendrore Evropiane luan rolin e rojes pranë Christine Lagarde – se ky është drejtimi i duhur.

Edhe vetë Jerome Powell, në përgjigje ndaj Trump-it, ka deklaruar se nëse nuk do të kishte “luftë tarifore”, ai do ta kishte ulur normën bazë të interesit amerikan prej kohësh.

Pra, bëhet fjalë për një betejë të vërtetë, të ashpër dhe shumë të gjatë që po zhvillohet rreth “kartëmonedhës së gjelbër”.

Dhe për ta shpjeguar këtë, janë të qarta të dhënat reale: dollari, në fakt, është monedha botërore: nga rreth 12,400 miliardë rezerva valutore në botë, gati 7,000 miliardë janë në dollarë (euroja vlen vetëm 2,200 miliardë, ndërsa monedha kineze vetëm 0.25 miliardë!) dhe gjithashtu në pagesat ndërbankare ndërkombëtare, dollari përdoret për mbi 50% të transaksioneve (euroja për 22%, juani për 3.8% së bashku me yen-in).

Ndaj, është e vërtetë ajo që Trump thotë kur paralajmëron qeveritë lidhur me tarifatat: “Ju nuk keni kartat në dorë” (You don’t have the cards). / Panorama Italia – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Rizespori insiston për Dellovën

Mbrojtësi i Kosovës, Lumbardh Dellova, me shumë gjasë do të largohet nga CSKA Sofja këtë verë. Është ekipi i Superligës së

Turqisë, Rizespori, që po insiston në transferimin e Dellovës të cilin e sheh si përforcim të rëndësishëm për sezonin e ri. Në fakt, mësohet

se Rizespori tashmë ka nisur kontaktet me CSKA Sofjen, duke ndërmarrë hapa zyrtarë për ta blerë Dellovën. 26-vjeçari në verën e vitit të

shkuar u transferua në Bullgari nga Ballkani i Suharekës dhe me CSKA Sofjen ka kontratë deri në vitin 2027. Dellova tashmë ka

regjistruar dy paraqitje në Superligën e Bullgarisë, kurse te Rizespori po synojnë të ofrojnë të paktën një milion euro për kartonin e tij.

27 SPORTISTË MBËSHTETEN NGA KOK-U PËR TA NDJEKUR NORMËN OLIMPIKE PËR LOS ANXHELOS 2028

PRISHTINË, 29 KORRIK - 27 sportistë do të mbështeten për ta ndjekur normën olimpikë për Lojërat Olimpikë Los Anxhelos 2028. Lista preliminare e propozuar nga komisioni i sportit u miratua në mbledhjen e fundit të Bordit Ekzekutiv të KOK-ut. Mbështetja për sportistë bëhet nga Solidariteti Olimpik i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe nga buxheti i KOK-ut. Bazuar në të arriturat e sportistëve dhe potencialin e tyre për t'u kualifikuar në LA 28, komisioni ka ndarë sportistët në tri grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë medalistja e dyfishtë olimpikë Distria Krasniqi (xhudo), që do të mbështetet me 1 350 dollarë, pasuar nga medalistja olimpikë Paris 2024, Laura Fazliu (xhudo) me 1 250 dollarë dhe Akil Gjakova (xhudo) e Donjeta Sadiku (boks) me nga 1 100 përkatësisht 1 000 dollarë.

Grupin e dytë e përbëjnë xhudistët Flaka Loxha e Dardan Cena, atleti Muhamet Ramadani, boksieri Bashkim Bajoku, taekwondosti, Bleron Ademi dhe notarja Hana Bejiqi. Të gjithë këta do të mbështeten me nga 600 dollarë. Në grupin e tretë janë 17



sportistë: Shpëtim Bajoku (Boks), Fatjona Kasapi e Shpati Zekaj (Xhudo), Mal Sahiti, Elion Agushi e Jon Gashi (taekwondo), Donat Sylja e Taulant Jakupi (Boks), Blin Kuka (Xhudo), Laurinë Gashi (Xhudo), Gresa Bakraqi (atletikë), Leon Thaqi (atletikë),

Lonisa Reka (mundje), Nexhat Sahiti e Drilon Ibrahim (shenjëtari), Albion Ymeri (triatlon) dhe Kaltrina Thaqi (Gjimnastikë), të cilët mbështeten me nga 350 euro. Mbështetja totale brenda një muaji do të jetë 14 250, ndërsa në vit 171 mijë.

SHKURT

Trepça transferon Diart Gecin

Ish-sulmuesi i Drenicës, Diart Geci, i është bashkuar Klubit të Futbollit Trepça. Lajmin e ka dhënë klubi nga Mitrovica i cili i ka uruar mirëseardhje 22-vjeçarit, duke theksuar se Diart Geci do të jetë shtyllë e rëndësishme e klubit. "KF Trepça ka kënaqësinë ta prezantojë përforcimin më të ri të skuadrës sonë. Diart Geci Diarti i bashkohet skuadrës sonë pas një sezoni të kaluar me KF Drenicën, ku tregoi cilësi dhe përkushtim. Me vizionin dhe dinamizmin e tij ai pritët të jetë një shtyllë e rëndësishme për skuadrën tonë", ka njoftuar KF Trepça.

Januzaj mund të rikthehet tek Anderlecht

Adnan Januzaj pritët ta mbyllë së shpejti aventurën e tij te Sevilla. Mesfushori belg është në bisedime për ta ndërprerë kontratën dhe të bëhet lojtar i lirë, që do t'i hapte rrugën një rikthimi tek Anderlecht. Klubi belg ka shfaqur interesim për t'i siguruar shërbimet e tij me kosto zero. Sevilla, ndërkohë, synon ta ulë buxhetin e pagave për të bërë afrime të reja në merkato.

Ademi pret në takim ekipin e ri të KFOR-it italian

Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka pritët në takim ekipin e ri të KFOR-it italian, me të cilin ka thënë se gjithmonë ka pasur një bashkëpunim të shkëlqyer. "Guidace Domenico, Naimo Benedetto dhe Paolino Alessandro, udhëheqës të kontingjentit të ri të KFOR-it italian, u urova mirëseardhje dhe së bashku rikonfirmuam vazhdimin e projekteve të përbashkëta. Në kuadër të mandatit të KFOR-it, kontingjenti italian është përgjegjës për inxhinierinë dhe në këtë drejtim ka kontribuar ndjeshëm në të gjitha kampet e Federatës së Futbollit të Kosovës. Falënderojmë KFOR-in për bashkëpunimin dhe mbështetjen!", ka shkruar Ademi në "Facebook".

Presidenti i Milanit: Nuk ofrojmë më shumë për Jasharin

MILANO, 29 KORRIK - Në shtëpinë e Milanit pista që çon tek Ardon Jashari mbetet aktive, por drejtuesit e klubit kanë përcaktuar qartë kufijtë financiarë të operacionit. Në një deklaratë gjatë Asamblesë së Serisë A, presidenti i klubit, Paolo Scaroni, theksoi: "Nuk duam të ofrojmë shumë. Ai dëshiron të vijë me çdo kusht". Fjalë që lënë pak vend për

interpretime dhe konfirmojnë qasjen e kuqezinjve për ta mbyllur marrëveshjen me kushtet e tyre. Milani e konsideron ofertën aktuale si të arsyeshme dhe nuk ka ndër mend të bëjë një rritje të mëtejshme të saj. Këto deklarata përforcojnë ato që më herët ishin bërë nga Igli Tare, i cili kishte theksuar se

Milani ka vënë në tryezë një propozim të rëndësishëm dhe se klubi është i bindur që ka vepruar drejt. Në këtë mënyrë, presioni kalon te Club Brugge, që tani duhet të vendosë nëse do ta pranojë ofertën e Milanit apo do të rrezikojë të humbasë një lojtar që, sipas vetë presidentit të Milanit, dëshiron të transferohet në Milano me çdo kusht.



Moreno: Nuk e meritoj pagën që marr

MADRID, 29 KORRIK - Ish-trajneri i ekipit kombëtar të Spanjës, Robert Moreno, përjetoi një nga momentet më të vështira të karrierës së tij si trajner. Klubi i tij aktual, Sochi, pësoi një humbje 4-0 kundër Akronit, pas së cilës Moreno doli para shtypit dhe pranoi singlerisht se i vinte

turp për atë që kishte ndodhur. “Nuk jam ndier kurrë kështu në karrierën time. Ndihej i turpëruar dhe përgjegjës. Nuk e meritoj pagën që marr”, ka thënë fillimisht Moreno pas ndeshjes. Pas kësaj, Moreno bëri një veprim që tronditi tifozët dhe

analistët e futbollit duke ofruar ta dhuronte gjysmën e pagës. “Nëse kjo nuk është e mundur për shkak të klauzolave në kontratë, do të gjej një mënyrë për ta dhuruar. Nuk dua të marr para që nuk i meritoj”, përfundoi ai. Moreno drejtoi ekipin

kombëtar të futbollit në vitin 2019, kur mori përkohësisht përsipër pozicionin pasi Luis Enrique dha dorëheqje për shkak të problemeve familjare. Pas tri ndeshjesh ai u emërua trajner deri në fund të “Euro 2020”, por Moreno dha dorëheqje në nëntor të të njëjtit vit.



Presidenti i FFK-së pret përfaqësuesit e klubit FC Eagles United nga Londra

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka pritur në një takim zyrtar përfaqësuesit e klubit FC Eagles United nga Londra, kryetarin e klubit Arben Hyseni dhe trajnerin Berat Hyseni. Ky takim kishte për qëllim forcimin e lidhjeve ndërmjet diasporës shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar dhe strukturave futbolistike në Kosovë. Gjatë bisedës u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë në fushën e zhvillimit të talenteve të rinj si dhe ndërlidhjen e talentëve shqiptarë që veprojnë në Angli me përfaqësueset e moshave të Kosovës. Ademi theksoi rëndësinë e diasporës në zhvillimin e futbollit të Kosovës dhe vlerësoi përkushtimin e Klubit FC Eagles United për promovimin e vlerave kombëtare përmes sportit. Në fokus të takimit ishte edhe ideja e përfshirjes së disa futbollistëve të rinj nga FC Eagles United në përfaqësueset e moshave të Kosovës. Kryetari Ademi u shpreh



i gatshëm ta mbështesë çdo iniciativë që synon avancimin e futbollistëve të rinj dhe krijimin e një ure bashkëpunimi të qëndrueshëm mes FFK-së dhe klubeve shqiptare jashtë vendit. Përfaqësuesit e FC Eagles United u shprehën mirënjohës për mikpritjen dhe gatishmërinë e FFK-së për t'i hapur dyert për talentet që rriten dhe formohen jashtë kufijve të Kosovës. Ata nënvizuan se kjo është një

mundësi e artë për të rinjtë që të ndihen pjesë e kombëtares së Kosovës dhe të kontribuojnë në sukseset e saj në arenën ndërkombëtare. Takimi u vlerësua shumë produktiv dhe shënon një hap të rëndësishëm drejt bashkëpunimeve konkrete në të ardhmen, duke forcuar rrjetin e futbollit shqiptar nëpër botë dhe duke ndërtuar ura të reja komunikimi dhe zhvillimi mes Kosovës dhe diasporës.

Katie Ledecky vazhdon të shkruajë histori, fiton medaljen e 22-të të artë në Botëror

SINGAPOR, 29 KORRIK - Në Kampionatin Botëror të Notit që po mbahet në Singapor, Katie Ledecky ka shtuar edhe një faqe të artë në legjendën e saj. Notarja amerikane 28-vjeçare ka fituar medaljen e 22-të të artë në këtë garë ndërkombëtare, duke dominuar në garën e 1 500 metrave në stil të lirë, distancë në të cilën ajo mban të 25 kohët më të mira të të gjitha kohëve. E sfiduar fillimisht nga australiania Lani Pallister, Ledecky arriti të notonte tre sekonda nën rekordin botëror, por në fund u ndal në kohën 15:16.44, që gjithsesi është koha e pestë më e mirë në histori, gjithashtu e saj. Përmasat e dominimit të saj janë mbresëlënëse; në këtë distancë ajo duket se garon në një epokë tjetër. Pas kësaj fitoreje Ledecky do të përgatitet për sfidën e radhës në



800 metra, ku e pret një përballje interesante me ‘ylin kanadez’ Summer McIntosh. Ndërkohë, David Popovic shkëlqeu në finalen e 200 metrave stil i lirë, duke përmbysur amerikanin Luke Hobson në metrat e fundit me një kthesë fantastike (26.43 sekonda). Rumuni fitoi me kohën 1:43.53, një nga dhjetë më të mirat në histori dhe e pesta për të personalisht.

Hobson (1:43.84) dhe japonezi Tatsuya Murasa (1:44.54) e plotësuan podiumin. Në garën e 100 metrave shpinë për femra, australiania Kaylee McKeown triumfoi sërish ndaj rivalës së përhershme Regan Smith, me kohën 57.16 sekonda, vetëm tri të qindtat larg rekordit botëror. Ishte fitorja e gjashtë me radhë ndaj Smithit në garat e mëdha që nga viti 2023, duke e konsoliduar McKeown notaren më të mirë të historisë në këtë stil. Te meshkujt triumfoi Pieter Coetzee nga Afrika e Jugut me kohën 51.85, duke lënë pas italianin Thomas Cecon dhe francezin Yohan Ndoe në një garë tepër të ngushtë. Ndërkohë, surpriza e ditës erdhi nga Anna Elendt, që fitoi 100 metra bretkosë për femra me kohën 1:05.19, duke lënë pas amerikanen Kate Douglass dhe kinezen Tang.

City projekton rikthimin e Palmerit

Manchester City është gati të shkruajë një kapitull të ri në historinë e merkatos së futbollit me një ofertë rekord prej 250 milionë paundësh për ta rikthyer Cole Palmerin në “Etihad Stadium”. Nëse kjo

shumë pranohet, transferimi do të bëhej më i shtrenjti në historinë e futbollit botëror. Palmeri u largua nga City në vitin 2023 për t'u bashkuar me Chelsea në një marrëveshje prej rreth 45 milionë paundësh.

Që atëherë sulmuesi anglez ka njohur një rritje të jashtëzakonshme, duke u kthyer në një nga pikat më të ndritura të skuadrës londineze. Paraqitjet e tij të shkëlqyera kanë bërë që Pep Guardiola të

kërkojë me ngulm rikthimin e tij. Trajneri katalanas e sheh Palmerin si një element thelbësor për fuqizimin e repartit ofensiv të “qytetarëve” dhe është i gatshëm të investojë një shumë të paprecedentë për

ta pasur sërish në skuadër. Tashmë mbetet për t'u parë nëse Chelsea do ta pranojë ofertën marramendëse dhe nëse Palmeri do të rikthehet aty ku filloi rrugëtimin në elitën e futbollit.

SHKURT

Diant Ramaj transferohet te Heidenheimi

Heidenheim ka konfirmuar zyrtarisht afrimin e portierit shqiptar Diant Ramaj nga Borussia Dortmundi. Gardiani 23-vjeçar i është bashkuar klubit gjerman me formulën e huazimit deri në verën e vitit 2026, ndërsa në marrëveshje është përfshirë edhe një opsion blerjeje. Ramaj vjen te Heidenheimi pas një sezoni mjaft aktiv në huazim, ku luajti për Ajaxin dhe Copenhagenin, duke grumbulluar 24 paraqitje në total. Statistikat e tij janë mbresëlënëse: 14 ndeshje pa pësuar gol dhe vetëm 15 gola të pranuar gjatë gjithë sezonit. Klubi i Bundesligës e cilëson portierin si një përforcim i rëndësishëm për skuadrën në prag të sezonit të ri, me shpresën se ai do të sjellë siguri dhe përvojë në prapavijë. I lindur në Gjermani, Ramaj ka origjinë shqiptare dhe është një emër në rritje në futbollin evropian. Ai ka qenë pjesë e ekipeve zinxhir të kombëtares gjermane, por nuk përjashtohet mundësia që në të ardhmen t'i bashkohet Kombëtares shqiptare.

Rudiger dhe Alaba drejt largimit nga Real Madridi

Real Madridi po përgatit një rinovim të thellë në mbrojtje dhe Antonio Rudiger (32-vjeçar) dhe David Alaba (33-vjeçar) janë në prag të largimit. Të dy mbërritën me parametra zero, por tashmë konsiderohen “të amortizuar”. Klubi nuk ka nisur bisedime për rinovim dhe, nëse ndodh, do të jetë vetëm për një vit. Situata më delikate është ajo e Alabas, që paguhet 10.5 milionë euro në sezon dhe refuzon të largohet pa përfunduar kontratën. Rudiger, ndonëse kontribuoi shumë sezonin e fundit, është pjesë e listës së largimeve për shkak të rinovimit të mbrojtjes me emra si Huijsen, Ascencio, dhe rikthimi i Militaos. Reali po synon ta transferojë edhe njërin nga dy mbrojtësit që luajnë në Angli: Saliba ose Konate.

Galatasaray bllokon transferimin e Moratës te Como

Galatasaray raportohet se ka refuzuar një ofertë prej katër milionë eurosh për ta ndërprerë huazimin e Alvaro Moratas nga Milani dhe për ta dërguar atë te Como, ndërkohë që Gabriel Strefezza është pranë kalimit tek Olympiacos. Situata e Moratës po zvarritet prej javësh, pasi sulmuesi ka arritur marrëveshje personale me Comon dhe dëshiron të rikthehet sa më shpejt në Serinë A. Megjithatë, përpara se Milani të realizojë këtë lëvizje, duhet ta ndërpresë marrëveshjen e huazimit që spanjollin nënshkroi me Galatasarayn në janar. Sipas “MilanNews”, Galatasaray ka refuzuar ofertën prej katër milionë eurosh për ndërprerjen e parakohshme të marrëveshjes, madje mund të dëshirojë ta mbajë 32-vjeçarin në skuadër. Ndërkohë, “Tuttomercatoweb” raporton se Como është pranë shitjes së Strefezas te Olympiacos për një shumë prej 8 milionë eurosh.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, dhe nën par. 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nën par. 7 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L "Përparimi" Sh. A e miratuar me datë 26.02.2025 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L "Përparimi" Sh. A, e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 1420/25 të datës 29.07.2025 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A, me datë 29.07.2025 shpallim.

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat 6 (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Koeficienti i pagës: 390.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga zëritori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe nënfaqet të kërkesës së eprorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojnë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të njëjtë. Shpallja është e hapur nga data 30.07.2025 deri me datë 13.08.2025 nga ora 16:00.

Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 21.08.2025.
- Afati për ankesë nga data 22.08.2025 deri me datë 25.08.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 04.09.2025.
- Afati për ankesë nga data 05.09.2025 deri me datë 08.09.2025.

- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 16.09.2025.
- Afati për ankesë nga data 17.09.2025 deri me datë 19.09.2025.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 26.09.2025.

Kalendar i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtruhet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e gjatja të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 paragrafi 1 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar që këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike/si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prapohen.

Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeye të përdorura në aspektin gjur, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

Përfundim

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punëtimi për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe qytetarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Daut Memaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - VIII shfmu "Naim Frashëri" Vlashnje.

- Arben Rramanaj shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

- "MAKINAPERTY" L.L.C, shpall të pavlefshëm certifikatën e biznesit më numër UNIK: 812161256.

- ERMIRA MURSELI, shpall te pavlefshme certifikatën e testit te maturës te SHMLM "Dr. Xheladin Deda".

- SPASENA RADOSAVLJEVIC B.I, shpall të humbur certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 810698631.

- Endrit Cena nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.M. "Hysni Zajmi", Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L